

Sistemi i sigurimeve sociale

Banorët e Zvicrës janë të mbrojtur nga rreziqet e ndryshme përmes sigurimeve shoqërore. Sigurimet ndihmojnë nëse ndonjëri e humb punën, apo sëmurët. Ato ndihmojnë gjithashtu edhe familjet dhe njerëzit e moshuar.

Parimet

Sigurimet sociale financohen nga banorët e Zvicrës. Për këtë aplikohet parimi i solidaritetit: shumica e popullsisë paguan, ndërsa individë dhe grupe të caktuara marrin mbështetje. Sigurimet sociale janë kryesisht obligative. Kontributet tërhiqen drejtpërdrejt nga paga e punonjësve. Por edhe punëdhënësit, të vetëpunësuarit dhe personat e papunë japin kontribute financiare.

Shërbimet

Sigurimet shoqërore mbështesin njerëzit në kushte të caktuara jetësore. Ata Ato bëjnë pagesa ditore, pensione ose shtesa, dhe mbulojnë koston e sëmundjeve dhe aksidenteve. Sigurimet sociale janë të gjitha të rregulluara nga shteti.

Kur ka mbështetje?

- Në moshë të shtyer, në rast vdekjeje dhe invaliditeti (3 shtylla: Sigurimi Pensional i Pleqërisë dhe Familjarëve, Sigurimi Invalidor (AHV/IV), Sigurimi Profesional, Sigurimi Privat)
- Në rast sëmundjeje dhe aksidenti (Sigurimi Shëndetësor dhe Aksidental)
- Në rast shtatzënie (Kompenzimi për Shtatzëni)
- Në rast papunësie (Sigurimi i Papunësisë)
- Nëse keni fëmijë (Shtesat për Familjet me Fëmijë)

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-ar.ch/sq/siguria-sociale/sistemi-i-sigurimeve-sociale